



Pranuar / Dorezuar Prilmen/Prodato Received/Delivery	06.09.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHICK	3354/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.401/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.401/2023 të datës 23.02.2023 të parashtruar nga ankuesi nga Suhareka, kundër Vendimit KA.nr.11/23 të datës 26.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.401/2023 e datës 23.02.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. *Mbetet në fuqi* Vendimi KA.nr.11/23 i datës 26.01.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 23.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1998/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.11/23 të datës 26.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me pretendimet ankimore se Konkursi me numër reference KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-024 për pozitën *Referent i Lartë* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë është përshkruar me shkelje procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin i

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 09.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1998/2023 të datës 23.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.11/23 të datës 26.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Ankesën e datës 19.01.2023 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Plotësimin e ankesës datë 23.02.2023; Referencën e datës 22.08.2012; Listën e Rezultateve të testit me shkrim i datës 09.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2219/2023 të datës 01.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2526/2023 të datës 09.03.2023; Konkursin e datës 10.11.2022 për pozitën Referent i Lartë dy pozita në Prokurorinë Themelore në Prishtinë; Vendimin DPSKPK/Nr.567/2022 i datës 29.11.2022 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Vendimin DPSKPK/Nr.580/2022 i datës 30.11.2022 ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Formularin për vlerësimin e listës së ngushtë i datës 02.12.2022; Listën përfundimtare të listës së ngushtë e datës 02.12.2022; Formularin për përcaktimin e kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë i datës 02.12.2022; Deklaratën për mos ekzistimin e konfliktit të interesit e datës 02.12.2022 te anterave të Komisionit Përzgjedhës; Njoftimin për kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë i datës 02.12.2022; Listën përfundimtare të përzgjedhjes të testit me shkrim i datës 09.12.2022; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim të datës 09.12.2022; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidateve të datës 16.12.2022; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës me gojë të datës 16.12.2022; Njoftimin për përzgjedhje përfundimtare të datës 23.12.2022; Rekomandimin për emërim të datës 20.12.2022; Raportin Final të Komisionit Rekrutues i datës 16.12.2022; Formularët e vlerësimit individual përfundimtar për ankuesin, kandidaten dhe Testin me shkrim i datës 07.12.2022 për ankuesin, kandidatin dhe dosja personale te kandidatit si: Kërkesën për punësim e datës 15.11.2022; Diplomën me Nr.3612 e datës 28.10.2015, Certifikatën I.A.Gj.nr.43/17 e datës 06.01.2027 të Gjykatës Themelore në Pejë; Certifikatën për dhënien e provimit të Jurisprudencës e datës 30.12.2021; kopje e ID-së, Certifikatën e datës 01.11.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega Deçan; Kontratën e Punës të datës 01.07.2021; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 05.07.2022 deri 10.11.2022; Dosjen Personale të ankuesit si: Kërkesën për punësim të datës 16.11.2022; Vërtetimin me numër protokolli 514 të datës 13.02.2021; Vërtetimin e datës 22.04.2022; Kopje e ID-së; Certifikatën e datës 14.11.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Suharekë; Dosjen personale të kandidates Ilirianë Haziri si: Kërkesën për punësim të datës 30.11.2022; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan e datës 24.11.2022; Vërtetimin e datës 23.01.2020; kopje e ID-së; Diplomën me Nr. 1776 e datës 16.01.2013; Diplomën me Nr. 1151 e datës 04.07.2016; Certifikatën me Nr. 03/2382 e datës 12.09.2014 e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; dhe Vërtetimin e Punësimit të datës 11.01.2018, emaili i Këshillit drejtuar ATK-së i datës 05.04.2023; emailin konfirmues nga ATK i datës 05.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale Kolegji ka gjetur së Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 10.11.2022 ka shpallur Konkursin me Nr.Reference: KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-024 për pozitën e punës *Referent i Lartë* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, duke u përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së bazuar në renditjen përfundimtare të Komisionit Përzgjedhës të datës 16.12.2022, kandidatja [] dhe [] janë vlerësuar si kandidatet më shumë pikë, ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsej 55.2 pikë, duke u cilësuar si kandidat jo fitues. Në pajtim me vlerësimet e Komisionit Përzgjedhës, Njësia e Burimeve Njerëzore të SKPK-së me datë 23.12.2022 ka shpallur njoftimin për kandidatet fituese Ilirianë Haziri me gjithsej 72 pikë dhe [] j 66.2 pikë.

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin për Përzgjedhje Përfundimtare të datës 23.12.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin KA.nr.11/23 të datës 26.01.2023, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi kundër Vendimit KA.nr.11/23 të datës 26.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore së gjatë Konkursit me Nr.Reference: KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-024 për pozitën e punës *Referent i Lartë* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë ka pasur shkelje procedurale, duke shtuar së nuk është bërë vlerësim i drejtë i intervistës me gojë, sepse me kandidatin që është përzgjedhur i dyti në listën përfundimtare kishim diferencë në testin me shkrim për 10 pikë; Lista e shkurtër nuk është bërë brenda pesë ditë punës siç përcaktohet me nenin 26 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil; nuk është bërë publikimin i rezultateve përfundimtare brenda 7 ditësh siç përshihet me nenin 41 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil;

Referuar Shpalljes së Konkursit me Nr.Ref. KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-024, si kritere për pozitën e punës *Referent i Lartë* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë janë përcaktuar : **Arsimi: Diplomë Universitare në Fakultetin Juridik, Administratë Publike dhe Shkenca Sociale, Përvoja e punës: së paku dy (2) vit përvojë pune profesionale.**

Lidhur me pretendimin për shkelje procedurale se kandidat që është përzgjedhur si kandidati i dytë ka diferencë në testin me shkrim për 10 pikë me pak së ankuesi, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave të lëndës ka konstatuar së ankuesi në testin me shkrim ka arritur gjithsej 67 pikë, ndërsa kandidatit i përzgjedhur [] ka arritur gjithsej 57 pikë, që janë pikë të mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të testimit me gojë, siç përcaktohet me nenin 36 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku thuhet se: "2.Kandidatët të cilët e kalojnë me sukses testimin me shkrim ose arrijnë të mbledhin së paku 50% të maksimumit të pikëve të të përcaktuar nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë", mirëpo, bazuar në përmbledhjen e vlerësime individuale të Komisionit Përzgjedhës gjatë intervistës më gojë, ankuesi është vlerësuar me gjithsej 217, ndërsa kandidati [] është vlerësuar me gjithsej 377 pikë. Andaj, në vështrim të dispozitave të nenit 40 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: "2. Pikët e përgjithshme në testimin me shkrim dhe me gojë mbledhen dhe pjesëtohen me dy. 3. Kandidati i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm

(testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pak se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara", rrjedhë së bazuar në përmbledhjen përfundimtare të testit me shkrim dhe gojë kandidati j është vlerësuar me gjithsej 66.2 pikë, duke u renditur si kandidati i dytë më i vlerësuar, ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsej 55.2 pikë, kështu që është i pabazuar pretendimi ankimor mbi këtë theks ankimor.

Kolegji i Këshillit referuar shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar së është i pa qëndrueshëm ligjrisht pretendimi ankimor së lista e shkurtër nuk është bërë brenda afatit siç përcaktohet me nenin 26 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse, Kolegji i Këshillit ka gjetur së Konkursi me Nr.ref.KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-024-020, ka qenë i hapur për aplikim nga data 10.11.2022 deri më datë 24.11.2022 (15 ditë kalendarike), kurse lista e ngushtë është shpallur më datë 02.12.2022, rrjedhimisht në kuptim nenit 26 të Rregullores Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Cive me të cilin përshihet se : "Përgatitja e listës së shkurtër zhvillohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas afatit të fundit të përcaktuar në shpalljen e rekrutimit", Kolegji i Këshillit konstatona së lista e ngushtë është përgatitur brenda afatit ligjor gjegjësisht brenda pesë (5) ditëve të punës nga dita e mbylljes së konkursit në fjalë, pasi që data 28 nëntor 2022 nuk ka qenë ditë pune për shkak të festës zyrtare të Pavarësisë së Republikës së Shqipërisë.

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit mbi bazën së publikimi i rezultateve përfundimtare nuk është bërë brenda shtatë (7) ditësh siç parashihet me nenin 41 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit konstaton së një procedurë e rekrutimit konsiderohet e përfunduar me përgatitjen e raporti final të Komisionit përzgjedhës i cili përmban edhe renditjen përfundimtarë të kandidatëve siç kërkohet me nenin 34 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, rrjedhimisht ne rastin konkret renditja përfundimtare e kandidatëve është bërë më datë 16.12.2022 ndërsa publikimi i rezultateve është bërë më datë 23.12.2022, pra brenda 7 ditëve.

Në kuptim të nenit 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar respektimin edhe të dispozitave tjera themelore procedurale dhe materiale referuar zhvillimit të procedurës së rekrutimit sipas konkursit me Nr.Ref. KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-024, për pozitën e punës *Referent i Lartë* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe rrjedhimisht ka konstatuar së shpallja e Konkursit është në pajtim me nenet 15, 16 dhe 17 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, testi me shkrim dhe gojë janë organizuar dhe mbajt në pajtim me nenin 32 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe së testi me shkrim ka qenë i përpiluar në pajtim me kërkesat e përcaktuara me nenin 36 të kësaj Rregullore, gjegjësisht Pjesa e I/Pjesa e Njohurive të Përgjithshme është përberë nga tre (3) ese, Pjesa e II-dytë/Pjesa e Aftësive të Përgjithshme dhe të Personalitetit, është përbërë nga dymbëdhjetë (12) pyetje me përgjigje të shumëfishta, si dhe Pjesa e III-tretë/Pjesa e Njohurive lidhur me vendin e punës është përberë nga gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje, prej tyre gjysma me përgjigje të shumëfishta dhe gjysma në formë eseje të shkurtra.

Në kuptim të parimit për emërim në shërbim civil mbi bazën e meritës dhe aftësisë profesionale, Kolegji i Këshillit ka analizua dokumentacionin e aplikimit të ankuesit dhe kandidatëve të suksesshëm nga dhe ka konstatuar se ankuesi posedon Diplomën me Nr.1192 të datës 12.07.2011 të lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes të cilës dëshmohet se i njëjti më datë 25.04.2011 ka përfunduar studimet themelore

universitare në Fakultetin Juridik dhe ka marr titullin Bachelor i Drejtësisë, ndërsa lidhur me përvojën profesionale të punës posedon Vërtetimin me numër protokoll 514 të datës 13.02.2021 të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, sipas të cili është vërtetuar së ankuesi ka qenë i angazhuar si konsulent i përkohshëm ligjor në Gjykatën Themelore në Prishtinë prej datës 01.08.2019 deri më datë 31.12.2020 si dhe posedon Vërtetimin e datës 22.04.2022 Kosovo Legal Services Company (KLSC), ku dëshmohej se ka punuar në këtë kompani në cilësi të Zyrtarit Ligjor për digjitalizimin e të dhënave penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë për periudhën nga data 23.07.2018 deri 31.07.2019. Ndërsa nga analizimi i dosjes personale të kandidateve të suksesshëm Kolegji ka gjetur se kandidati _____ posedon Diplomën me Nr.3612 të datës 28.10.2015 të lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes të cilës dëshmohej se më datë 25.04.2011 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik dhe ka marr titullin Jurist i Diplomuar-Bechelor, kurse lidhur me përvojën profesionale të punës posedon Certifikatën I.A.Gj.nr.43/17 të datës 06.01.2017 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë sipas të cilës është vërtetuar se nga data 05.01.2016 deri më datë 04.01.2017 pa përfunduar praktikën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega Deçan, sipas Kontratës së Punës të datës 01.07.2021 e shoqëruar edhe me Pasqyrën e Trustit Pensional rrjedhë së i njëjti nga data 01.07.2021 deri muajin qershor 2022 ka punuar në zyrën e Avokat _____ në pozitën Zyrtar Ligjor, përvojë profesionale e dëshmuar me pasqyrën e Trustit si dhe konfirmimin e ATK-së të datës 05.04.2022, se i njëjti është i deklaruar për këtë periudhë në listën e punëtorëve të Avokati _____. Ndërsa kandidatja e përzgjedhur _____ i posedon Diplomën me Nr.1776 të datës 16.01.2013 të lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes të cilës dëshmohej se e njëjta më datë 25.04.2011 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik duke marr titullin Jurist i Diplomuar, ndërsa lidhur me përvojën profesionale të punës posedon Certifikatën me Nr.03/2382 të datës 12.09.2014 të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës sipas të cilës është vërtetuar së e njëjta nga data 02.09.2013 deri më datë 01.09.2014 pa përfunduar praktiken gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, posedon Vërtetimin e datës 23.01.2020 të lëshuar nga Kosovo Legall Services Company (KLSC) ku dëshmohej se e njëjta ka punuar në këtë kompani në cilësi të Zyrtarit Ligjor lidhur me Projektin e Sistemit Qendror të Evidencës Penale të financuar nga BE-ja, për periudhën kohore 23.07.2018 deri me 23.01.2020, përvojë e konfirmuar edhe nga ATK-ja së kandidatja e përzgjedhur ka qenë e deklaruar në listën e pagave për këtë periudhë kohore, si dhe zotëron Vërtetimin e punësimit të datës 11.01.2018 të lëshuar nga Checchi and Company Consulting INC sipas të cilës vërtetohet se nga data 20.10.2015 deri më datë 15.10.2018 ka qenë e punësuar si Zyrtar për Zvogëlimin e Lëndëve Përmbareuese në Gjykatat e Kosovës. Andaj, nisur nga kjo gjendje faktike, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës në mënyrë të drejtë ka vlerësuar aplikacionet e ankuesit dhe kandidateve të përzgjedhur, duke vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1arsinimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës, shkathtësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera të meritë.* Mirëpo, Kolegji në bazë vlerësimit përfundimtar të Komisionit Përzgjedhës ka konstatuar së kandidatët e përzgjedhur janë vlerësuar si kandidat me më shumë pikë respektivisht kandidatja _____ me 72 pikë duke u renditur si kandidatja e parë, kandidati _____ j me 66.2 pikë duke u renditur si kandidati i dytë, ndërsa ankuesi ka arritur gjithsej 55.2, kështu që mbi këtë bazë, rezulton së Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku parashihet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*".

Nisur nga konstatimet si me sipër, Kolegji vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën *Referent i Lartë në Prokurorinë Themelore në Prishtinë* është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafi 9 dhe nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës, dhe si rrjedhojë Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.Nr.11/23 i datës 26.01.2023 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.*

Përmbledhur si më lart, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.401/2023

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në SKPK-së; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.